



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 925/14 Prot.

Tiranë, më 25.03 2025

V E N D I M

Nr. 43 dt. 25.03 2025

“PËR
INTERPRETIMIN E NENIT 58/1 TË STATUTIT TË UNIVERSITETIT TË SPORTEVE
TË TIRANËS”

Mbështetur në nenin 38 dhe 63 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 20 dhe nenin 58/1 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe nenin 36 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, Senati Akademik në mbledhjen e datës 25.03.2025,

V E N D O S I:

1. Interpretimin e nenit 58 pika 1 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, sipas këtij përcaktimi: “Për përfitimin e vitit akademik sabbatik, personeli akademik i kategorisë “Lektor” dhe “Profesor”, duhet të këtë jo më pak se 7 vite pune me kohë të plotë pranë Universitetit të Sporteve të Tiranës”.
2. Ky Vendim i përcillet për njohje, zbatim dhe publikim njëjësive kryesore të UST dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

